

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Për tri kërkesa, tre vendime. Për tri kërkesa për komisione hetimore, tre vendime të ndryshme. Kërkesa për komision hetimor për zgjedhjet pranohet. Pavarësisht të gjitha përgjërimeve që bën ai që ishte këtu apo edhe këta të tjerët për patronazhistët, gjeni vend dhe futuni patronazhistë. Minimumi do t'ju dalë emri kudo, me bojë të zezë. I dyti, vendimi për insineratorët. 400 milionë euro. Po, dakord, e pranoj. Në momentin që do të diskutohet edhe një herë në Konferencën e Kryetarëve, në respekt edhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, me shumë përvullësi, edhe aty, duke ndjekur të gjitha udhëzimet procedurale, kemi bërë të gjitha lëshimet e duhura për të arritur në synimin e duhur. Të shpresojmë nëse do t'i bindeni. Kërkesa e tretë për Beketin nuk pranohet, pa thënë cili vendim i Gjykatës Kushtetuese, cili parim preket, cila procedurë shkelet.

U tha njëherë që ka ardhur nga Avokatura e Shtetit, por u la. Erdhi sot dhe tha jo, nuk dua. Në fakt ajo që duhet parë është se çfarë ndryshon në të tre vendimet. Tek i pari sëpata e komisionit hetimor do të bjerë te patronazhistët. Ju ka shitur, patronazhistë! Te dy të tjerët ka hallin e vet. 400 milionë euro të insineratorëve i ka mbi kurriz ai dhe Ahmetaj i vet, kurse Beketin e ka të gjithin vetë mbi kurriz. Sa herë që bëhet fjalë për çështje që vijnë afër tij, tregon fytyrën e vërtetë. Nga e morëm vesh ne për Beketin? Po fare thjeshtë. Hapni celularët dhe klikoni një faqe në web “Parlo io”, “Flas unë”, dhe del fytyra e Beketit, i cili një muaj më parë ka hapur në Piazza di Spagna një pankartë të madhe, ku thotë: “Fitova”. Ka të drejtë, sepse ishte i vetmi person hundëlesh, italian, qejfli gjyqesh, i cili shfrytëzoi të gjitha të drejtat që jep drejtësia Amerikane në këtë rast. Ishte në Shqipëri dhe në 9 qershor 2015, duke marrë shkas nga një twitter i Kryeministrit, ku thoshte: “më në fund ia arritëm të kufizonim burimet e parave të pista që furnizonin Agon Channel”, një televizion, iu drejtua gjykatës në Uashington, sepse mbi të u sulën tatimorë, prokurorë, polici, Engjëll Agaçi, me bekimin e Edi Ramës dhe sot fatura e dëmit është 120 milionë euro. Në 2 400 000 shqiptarë që jetojnë në Shqipëri, i bie 50 euro për çdo shqiptar. I majtë, i djathtë, të rinj, të reja, pleq, pensionistë, me para, pa para, të dëshpëruar apo jo, 50 euro do të paguhet nga xhepi i gjithsecilit për tekat e këtij. Nuk mjafton rritja e çmimit të bukës, nuk mjafton rritja e çmimit të naftës, nuk mjafton papunësia, por secili prej shqiptarëve duhet të paguajë edhe 50 euro për të. Konfidencialiteti i ka nxjerrë të gjitha. Beketi vetë. Tri arsye ka. Policia e Edi Ramës i mësyu në biznesin e vet, në medien e vet, Sekretari i Përgjithshëm me emër Engjëll Agaçi thërret Beketin dhe i thotë: “Do të dish ti pse t'i sekuestrojë prokuroria pronat? Që të dalësh nga kjo situatë duhet të bësh ortakëri me një konkurrent tjetër”, që ia afronte pikërisht ai. Kjo është e gjithë situata për të cilën gjithsecili duhet të paguajë 50 euro. Historia nuk përfundon këtu. Nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka asnjë parim të Kushtetutës, nuk ka asnjë rregull ligjor që të thotë: “Po nuk desh Edi Rama komisionet hetimore nuk ngrihen”. Ajo që duhet parë nga të gjithë është: “Çdo të bëjnë shqiptarët me këto 50 euro që do të duhet të paguajnë? A do të duhet të tregohemi edhe ne hundëleshë si italianit? Çfarë na mungon? Asgjë. Vetëm fakti që në këtë histori një gjëje të gjithë shqiptarët do të duhet t'i japin sqarim, të majtë dhe të djathtë: këto euro pse të mos i paguajë ky, për tekat e tij, për epshet e tij, sepse në vitin 2015, duke zënë për fyti biznesin dhe medien që guxoi të qortonte qeverinë, ua uli kokën të gjitha medie dhe e shikoni se cili është rezultati sot. Kështu që, është fare njerëzore që gjithsecili nga ata të cilët sot nuk kanë 50 euro për të paguar për epshet e tij, të kërkojnë një gjë fare të thjeshtë: paratë t'i paguajë ky.

Rruga e parë dhe e vetme është komisioni hetimor. Të hedhim dritë. Pse e urdhëroi policinë? Pse urdhëroi prokurorinë, që e vuri nën thundra? Pse urdhëroi Engjëll Agaçin? Pse nxori arrestin? U detyrua gjykata civile që të vendoste kundër ekstradimit të këtij njeriu, që sot ka fituar me të drejtë, kusuret e të cilit do të duhet t'i paguajmë ne të gjithë. Pse? Le t'i paguajë ky. Këtë kërkojmë ne, as më shumë e as më pak, të mos paguajë asnjë shqiptar, as i majtë, as i djathtë, por t'i paguajë vetëm një njeri. Ka para, mjafton të shkoni deri në Surrel. Vetëm kaq, të paguajë kokërr më kokërr dëmin që ka shkaktuar. Shqiptarët, të vetmen zgjidhje që kanë pas këtij momenti është thjesht dhe vetëm një: hundëlesh. Për t'i treguar dhe thyer qafën këtij njeriu. Kaq e thjeshtë është. Nuk ndërpritet sot kjo. Nuk keni asnjë lloj mundësie. Hetimi do të bëhet, letrat janë të hapura, emrat janë fare të qartë, gjithçka do të bëhet transparente dhe në fund do të përfundojë në SPAK. Koha është për shqiptarët tashmë.